



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për mediat

“Mbi seancat e zhvilluara me operatorët e tregut të gazit të lëngshëm”

Qershor 2010 - Në kuadër të hetimit në tregun e ngarkimit shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm, Komisioni i Konkurrencës, organizoi disa séanca me operatorët kryesorë të tregtimit të gazit të lëngshëm në vend. Këto takime u organizuan për t'u njohur me problematikën e këtij tregu në përgjithësi, si dhe veçanërisht për situatën e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit. Në këto takime morën pjesë përfaqësues të ndërmarrjeve Mare Oil, Global Gaz, InterGaz, AM Gaz, dhe Kalaja.

Pikat kryesore të diskutimeve u përqendruan në vështirësitë që kanë disa nga operatorët importues e tregtues të gazit për ngarkimin-shkarkimin dhe depozitimin e gazit në portet e Porto Romano, Durrës dhe të Gjirit të Vlorës.

Pas ankesave të paraqitura nga disa operatorë të këtij tregu, Autoriteti i Konkurrencës ka hapur një hetim paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm. Gjithashtu Komisioni i Konkurrencës ka marrë një vendim në formën e masës së përkohshme, ku detyrohet operatori Petrolifera Italo Albanese (PIA) që të sigurojë aksesin e të gjitha ndërmarrjeve të interesuara në infrastrukturën portuale në Gjirin e Vlorës (porti Vlora 1) deri në përfundim të hetimit në këtë treg.

